



GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES SË NXËNËSVE
NË FUND TË CIKLIT TË TRETË TË SHKOLLËS FILLORE

MAJ, VITIT MËSIMOR 2017/2018

UDHËZIM

Koha për zgjidhjen e testit është **70 minuta**.

Mos e hapni testin dhe mos filloni t'i zgjidhni detyrat derisa të mos ju japë leje mësimdhënësi kujdestar.

Testi DUHET të jetë i shkruar me laps kimik ose me stilolaps.

Shkruani lexueshëm me shkronja dore.

Nëse shkruani me shkronja shtypi, theksojeni shkronjën e madhe aty ku duhet të jetë. Respekto rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore. Nëse mendon se ke gabuar me rastin e zgjidhjes së detyrës, vendos një vijë të kryqëzuar (X) mbi të dhe zgjidhe përsëri.

Nuk guxon të përdorësh korrektorin.

Detyrat nuk e ke për detyrë t'i zgjidhësh me rend ashtu siç janë dhënë në test.

Nëse e përfundon punën më parë, kontrolloji edhe një herë zgjidhjet tua.

Detyra do të vlerësohet me zero (0) pikë nëse:

- është e pasaktë
- është e palexueshme dhe nuk është shkruar qartë përgjigjja
- është e shkruar me laps të thjeshtë
- është shkruar ose qarkuar edhe përgjigjja e saktë dhe e pasaktë

ME FAT!

SHIFRA E NXËNËSIT

Duke shfrytëzuar pyetjet e anketës dhe pasqyrën tabelare të rezultatit të anketës puno detyrën 1 dhe 2.

PYETJET E ANKETËS PËR NXËNËSIT

1. A e dini se çfarë është Kolonia e Artit dhe ku ndodhet ajo?
 2. A shkon paralelja juaj në vizita të organizuara në Koloninë e Artit?
 3. A shkon në mënyrë të pavarur në Koloninë e Artit?
 4. A ndalesh ndonjëherë të shikosh ndonjëherë nga skulpturat e reja?
 5. A ju është paraqitur rasti të vëzhgosh skulptor duke punuar?
 6. A keni kontaktuar me ndonjë nga skulptorët e Kolonisë?
 7. A do të ishte Kolonia e Artit në listën e vendeve në të cilën do t'i kishe çuar shokët/shoqet që të kanë ardhur mysafirë?
 8. A e konsideroni të drejtë që artistët të vijnë nga vende të tjera të skulpturojnë në vendin tënd?
- Ju lutemi të arsyetoni përgjigjen e fundit.

REZULTATI I ANKETËS ME NXËNËSIT

| Nr. r. | Përgj. | F - VIII | F - VII | F - VI | GJITH. | F-% | M - VIII | M - VII | M - VI | GJITH.-M | M-% | GJITH. | GJITH.-% |
|--------|--------|----------|---------|--------|--------|-------|----------|---------|--------|----------|-------|--------|----------|
| 1. | PO | 21 | 15 | 6 | 42 | 87,50 | 18 | 9 | 9 | 36 | 85,71 | 78 | 86,66 |
| | JO | 3 | 3 | - | 6 | 12,50 | - | 3 | 3 | 6 | 14,29 | 12 | 13,34 |
| 2. | PO | 16 | 12 | 4 | 32 | 66,66 | 10 | 6 | 7 | 23 | 54,76 | 55 | 61,11 |
| | JO | 8 | 6 | 2 | 16 | 33,34 | 8 | 6 | 5 | 19 | 45,24 | 35 | 38,89 |
| 3. | PO | 6 | 15 | - | 21 | 43,75 | 3 | 6 | 6 | 15 | 35,71 | 36 | 40,00 |
| | JO | 18 | 3 | 6 | 27 | 56,25 | 15 | 6 | 6 | 27 | 64,29 | 54 | 60,00 |
| 4. | PO | 24 | 18 | 6 | 48 | 100% | 15 | 12 | 12 | 39 | 92,85 | 87 | 96,66 |
| | JO | - | - | - | - | - | 3 | - | - | 3 | 7,15 | 3 | 3,34 |
| 5. | PO | 12 | 12 | 6 | 30 | 62,50 | 18 | 12 | 6 | 36 | 85,71 | 66 | 73,33 |
| | JO | 12 | 6 | - | 18 | 37,50 | - | - | 6 | 6 | 14,29 | 24 | 26,67 |
| 6. | PO | 3 | 3 | - | 6 | 12,50 | - | 6 | 6 | 12 | 28,57 | 18 | 20,00 |
| | JO | 21 | 15 | 6 | 42 | 87,50 | 18 | 6 | 6 | 30 | 71,43 | 72 | 80,00 |
| 7. | PO | 18 | 15 | 6 | 39 | 81,25 | 12 | 9 | 12 | 33 | 78,57 | 72 | 80,00 |
| | JO | 6 | 3 | - | 9 | 18,75 | 6 | 3 | - | 9 | 21,43 | 18 | 20,00 |
| 8. | PO | 21 | 18 | 6 | 45 | 93,75 | 15 | 12 | 12 | 39 | 92,85 | 84 | 93,33 |
| | JO | 3 | - | - | 3 | 6,25 | 3 | - | - | 3 | 7,15 | 6 | 6,64 |

1. A) Në cilën pyetje nxënëset (F) kanë dhënë më së shumti përgjigje negative?

1 pikë

B) Cila pyetje ka fituar më së shumti përgjigje pozitive?

1 pikë

2. Duke shfrytëzuar të dhënat e përqindjes plotëso tekstin në vijim.

_____ % e nxënësve dinë se çfarë është dhe ku gjendet Kolonia e Artit. Rezultatet tregojnë se nxënësit më shpesh shkojnë në Koloni të organizuar se sa vetëm, dhe për këtë më shpesh vajzat se sa djemtë.

_____ % e vajzave dhe madje _____ % e djemve kanë vëzhguar skulptorët duke punuar, por janë pak, vetëm _____ % prej tyre kanë kontaktuar me ta.

_____ % e nxënësve do t'i çonin mysafirët në Koloni.

1 pikë

Lexo fragmentet nga teksti dhe përgjigju në pyetjet 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8.

1. Iu ngjitën udhës që çonte te kasollja e plakut dhe hynë në kasolle nga dera e hapur. Plaku e mbështeti direktun me pëlhurën e mbështjellë rreth tij mbi mur, dhe djali vuri arkën dhe veglat e tjera aty pranë. Direku ishte i gjatë pothuaj sa kasollja.
2. Kasollja ishte ndërtuar me degë palmash mbretërore që quhen guano dhe brenda kishte një shtrat, një tryezë, një karrige, dhe fundshtrorjen prej balte, në një vend për të gatuar me qymyr druri. Në muret ngjyrë kafe, të thurura me gjethe të dendura dhe me fibra të guanos, ishin vënë piktura me ngjyra, njëra zemra e shenjtë e Jezuit dhe tjetra Shën Mëria e Virgjër e Kobres.
3. Më parë, aty në mur varej një fotografi me ngjyra, e gruas së tij, por ai e kishte hequr andej, sepse kur e shihte e ndjente veten shumë të vetmuar, dhe e kishte vënë në raftin e qoshes, nën këmbishën e larë.
...
Ai është një peshk i jashtëzakonshëm dhe kushedi ç' moshë ka, mendoi plaku. Asnjëherë nuk kam zënë një peshk kaq të fortë ose që të sillet në mënyrë kaq të çuditshme. Ndoshta prandaj dhe nuk kërcen, sepse është peshk i mençur.
4. - Ç' ke sonte për darkë? - pyeti djali.
- Një vorbë oriz të verdhë me peshk. A do të hash ca?
- Jo unë do të ha në shtëpi. A do të ta ndez zjarrin?
- Jo. Do ta ndez më vonë. Ose do ta ha orizin të ftohtë.

3. Kush është personazhi kryesor në tregim?

1. Shën Mëria e Virgjër e Kobres
2. Plaku
3. Djali

Rretho numrin pranë përgjigjes së saktë.

1 pikë

4. Cili tipar i personazhit është forca shtytëse e veprimit në tregim?

1 pikë

5. Në cilën vetë rrëfëhet ngjarja në pjesën e 1-rë të tekstit dhe kush dialogon në pjesën e 3-të të tekstit?

Veta e _____.

Dialogu në mes:
_____ dhe _____.

2 pikë

6. Çfarë raporti kanë ndërmjet veti dy personazhet që dialogojnë në fragmentin nr. 4?

1 pikë

7. A) Lexo pjesën e tretë të tekstit, pastaj rretho numrin para figurës stilistike të përdorur me shprehjen „peshk i mençur“.

1. krahasim
2. epitet
3. metaforë

1 pikë

B) Sqaro domethënien e figurës stilistike.

1 pikë

8. ...fundshtrorë prej balte (pjesa e 2-të nga teksti)

Shkruaj sinonimin e fjalës fundshtrorë.

1 pikë

**9. Përcakto llojin e fjalëve të fjalisë së mëposhtme.
(fjalja është e nxjerrë nga pjesa e 1-rë e tekstit)**

Direku ishte i gjatë pothuaj sa kasollja.

| | | | |
|---------|-------|----------|-------|
| Direku | _____ | pothuaj | _____ |
| ishte | _____ | sa | _____ |
| i gjatë | _____ | kasollja | _____ |

2 pikë

10. Në dialogun e mëposhtëm gjej format foljore dhe shkruaj për secilën nga ato vetën dhe numrin.

*- Një vorbë oriz të verdhë me peshk. A do të hash ca?
- Jo unë do të ha në shtëpi. A do të ta ndez zjarrin?*

1 pikë

11. Përcakto rasën e fjalëve të nënvizuara në fjalinë e dhënë.

Iu ngjitën udhës që çonte te kasollja e plakut dhe hynë në kasolle nga dera e hapur.

| | |
|----------|-------|
| udhës | _____ |
| kasollja | _____ |
| e plakut | _____ |
| kasolle | _____ |
| dera | _____ |

2 pikë

12. Sqaro përdorimin e presjes në fjalinë:

E keqja njeriut nuk i vjen nga urtësia, por nga mendjemadhësia.

2 pikë

13. Lexo fragmentet dhe shkruaj llojin e stilit të përdorur.

1. Atë ditë ne po luanim me gurë, kur befas, njëri prej nesh thirri me tmerr: Magjia! Vrapuam të gjithë te shoku dhe qëndruam rreth e rrotull si të ngrirë. Ai ishte bërë dyll i verdhë dhe tregonte me gisht në tokë. Atje, mes gurëve, dukej një magji, e madhe sa një grusht.

2. Kompjuterët i bëjnë të gjitha veprimet e tyre duke përdorur kodin binar, që përmban vetëm dy numra: 0 dhe 1. Çdo 0 dhe 1 quhet bit (shkurtim i fjalës binary digit = shifër binare). Një varg tetë-bitësh i quajtur byte (bajt), përdoret në rastin e informacioneve të vogla si: një shkronjë, një numër apo një shenjë pikësimi.

2 pikë

14. Shkruaj autorin, gjininë letrare dhe llojin letrar të cilit i përket vepra e theksuar (e specifikuar).

| VEPRA | AUTORI | GJINIA LETRARE | LLOJI LETRAR |
|---------------------------------------|--------|----------------|--------------|
| <i>Gjenerali i ushtrisë së vdekur</i> | | | |
| <i>Plaku dhe deti</i> | | | |
| <i>Kulla</i> | | | |

3 pikë

15. Lexo fragmentin nga drama "Nita" të Josip Relës, pastaj puno detyrën.

ZEFI – (Ulet në mur. Mbështet kokën te dora.): Babë, o babë, ku je?... Ç'të bëj pa ty?... Të pres akoma, të pres?... Oh!

NITA – (Nga dera): Zef, ti je? Ç' bën aty?

ZEFI – Nita?!

NITA – Zef, ç'të ka ndodhur, Zef?

ZEFI – Të humba, Nita, të humba!...

Nëse në fragment ekziston tipari dramatik, rretho PO , gjej dhe shkruaj në tabelë pjesën e tekstit nga fragmenti. Nëse nuk ekziston tipari dramatik, rretho JO.

| TIPARI DRAMATIK | PO | JO | DËSHMIA NGA FRAGMENTI |
|---------------------------|----|----|-----------------------|
| Në fragment ka role | PO | JO | |
| Në fragment ka emocion | PO | JO | |
| Në fragment ka narracion | PO | JO | |
| Në fragment ka akte/pamje | PO | JO | |

2 pikë

Lexo poezinë pastaj zgjidh detyrën 16 dhe 17.

TË BUZËQESHURIT E SAJ

Buzëqeshja e saj në zenit në mes të verës
hidhet bashkë me ujëvarat e Niagarës
shkëlqimin i largët me borë i Mont Everestit
buzëqeshja e saj prej valltareje në kimon
më lini me shiun në buzëqeshjen e saj
më lini me puthjen në buzët e saj
pak nga zjarri e nga akulli pak
pak nga dielli mbi pjeshkën
pak nga ëndrra pak nga loti pak drita e hënës

Adem Gajtani

16. Nënvizohet karakteristikat të cilat kanë të bëjnë me poezinë.

Poezi lirike përshkruese, strofëzimi, motivi i buzëqeshjes, poezi lirike e dashurisë, mungesë pikësimi

1 pikë

17. Cili është funksioni i krahasimit në poezinë „Të buzëqeshurit e saj“?

1 pikë

18. Shkruaj shkurtesat e fjalëve në vijim:

bie fjala _____

era e re _____

për shembull _____

1 pikë

19. A) Nënvizohet fjalën e shkruar saktë.

s'battoj, zbatojë, zbattoj, sbatoj

1 pikë

B) Arsyeto përgjigjen.

1 pikë

20. Shkruaje një hartim prej 80 deri në 180 fjalë që ka lidhshmëri mes vetes në temën:
Në orë më cingëroi zilja e telefonit

Në hartim:

→ Shkruaj përse nuk e ke fikur telefonin para se të fillojë ora.
→ Përshkruaj reagimin e arsimtarit/arsimtares dhe të shoqërisë kur kanë dëgjuar zilen e telefonit.

→ Përshkruaj se si je ndjerë në atë moment.

→ Përshkruaj reagimin tënd.

→ Shkruaj se si ka përfunduar ajo ngjarje (p.sh.: a je ndëshkuar ose jo, apo diçka e ngjashme).


Shkruaj lexueshëm dhe respekto kërkesën për numrin e fjalëve +/- 10% (vlerësohet hartimi i cili ka nga 72 deri në 198 fjalë; nëse hartimi ka më pak se 72 fjalë NUK LEXOHE T FARE, kurse në fjalën e 198-të NDËRPRITET leximi).

18 pikë

NË ORË MË CINGËROI ZILJA E TELEFONIT

PLANI PËR SHKRIMIN E HARTIMIT

Handwriting practice lines consisting of 10 sets of solid top and bottom lines with a dashed midline.



E PLOTËSON KOMISIONI PËR VLERËSIM

Numri i përgjithshëm i pikëve të fituara në test: _____

Nota: _____

KOMISIONI:

VLERËSUESI KRYESOR: _____

Data _____ 2018